

VENDIM
Nr.210, datë 25.2.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1661, DATË 29.12.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE SPITALORE NGA
SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, pika 2, shkronja “c”, e 26 të ligjit nr.7870, datë 13.4.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 26 të ligjit nr.9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikës e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shtojca nr.2, që përmendet në pikën 2 të vendimit nr.1661, datë 29.12.2008 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Shtojca II

	Buxheti 2009			
	Propozim për ndryshime në buxhetin e shërbimit spitalor			
			000 lekë	
Nr.	Institucioni dytësor	Ndryshimet në buxhetin 2009		
		Mallra e shërbime (602)		
		pakësime	shtesa	
1	Berat	4,000		
2	Dibër	4,000		
3	Fier	3,000		
4	Gjirokastrë	2,000		
5	Korçë	2,000		
6	Kukës	2,000		
7	Lezhë	1,000		
8	Librazhd	1,000		
9	Lushnjë	2,000		
10	Mat	1,000		
11	Skrapar	1,000		
12	Shkodër	30,000		
13	QSUT		125,000	
14	Mat.nr.1	2,000		
15	Sanatoriumi	2,000		
16	Vlorë	3,000		
	Rezervë e pashpërndarë	65,000		
	TOTALI	125,000	125,000	